



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim – Opštinska Kancelarija za Zajednice i
Povratak – Office for Communities and Returne



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Zyra Komunale për Komunitet dhe Kthim
Opšt. Kancelarija za Zajednice i Povratak



NJOFTIM

-IX- Nr. i prot. 03/22 Më 21.04 2022
Br. prot. Dt.
RAHOVEC - ORAHOVAC

Në mbështetje të dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-164, për financimin e programeve të veçanta të banimit si dhe gjendjes emergjente për intervenim, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim në Komunën e Rahovecit ka hapur afatin për aplikim për mbështetje në renovim të shtëpive, për pjesëtarët e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian nga Komuna e Rahovecit.

Projekti parasheh këto modele për ndërtim:

- MODELI 1: Ndërtimi i banjos funksionale dhe riparimi i shtëpisë.
- MODELI 2: Riparimi i shtëpisë ekzistuese ose ndërtimi i aneks hapësirës së banimit me banjo funksionale deri në 27 m².
- MODELI 3: Riparimi i shtëpisë ekzistuese ose ndërtimi i aneks hapësirës së banimit me banjo funksionale deri në 41 m².
- MODELI 4: Riparimi i shtëpisë ekzistuese ose ndërtimi i aneks hapësirës së banimit me banjo funksionale deri në 60 m².

AFATI I APLIKIMIT

Nga data: 21.4 2022 deri më: 5.5.2022
(çdo ditë pune nga ora 08:00-16:00)

Kërkesat për aplikim dorëzohen në zarf të mbyllur në zyrën e pranimit në katin e I-rë të objektit të Komunës, me destinacion për Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK).



VOICE OF ROMA, ASHKALI
AND EGYPTIANS IN KOSOVO

Ky projekt mbështetet në bashkëfinancim në mes të Kuvendit Komunal Rahovec dhe
OJQ-Zëri i Romëve, Ashkalinjve and Egjiptianëve.



MËNYRA E APLIKIMIT

- Kërkesa zyrtare për renovim të shtëpisë në drejtim të ZKKK-së.
- Të posedoj pronën në emrin e tij/saj personal/e (të bashkëngjitet fleta poseduese).
- Për personat me asistencë sociale (të bashkëngjitet kartoni i asistencës sociale).
- Të bashkëngjiten fotografitë (e printuara) të gjendjes së shtëpisë, posaçërisht të hapësirës për renovim.
- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës dhe banor i Komunës së Rahovecit (kopja e letërnjoftimit ose pasaportës).
- Të bashkëngjitet certifikata e anëtarëve të familjes.

KRITERËT E PËRZGJEDHJËS

- 1.1. Statusi i banimit;
- 1.2. Lartësia e të ardhurave;
- 1.3. Gjendja shëndetësore;
- 1.4. Invaliditeti;
- 1.5. Struktura e familjes

Pas pranimit të kërkesave, komisioni profesional i formuar nga Komuna e Rahovecit, do të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve si dhe do të bëjë verifikimin në terren për çdo aplikim. Kërkesat do të trajtohen sipas gjendjes dhe prioritetit emergjent.



Ky projekt mbështetet në bashkëfinancim në mes të Kuvendit Komunal Rahovec dhe OJQ-Zëri i Romëve, Ashkalinjve and Egjiptianëve.

